

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për krime të rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar, Have Haliti dhe Driton Muharremi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesionale Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve G.M dhe K.Q, i akuzuari G.M për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPK, kurse e akuzuara K.Q për shkak të veprës penale dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes se veprës penale nga neni 305 par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës se PTH-DKR në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.472/14 të datës 20.11.2014, në seancën e Kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 të KPPK-së, me datë 20.01.2016 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa PTH-DKR në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.472/14 të datës 20.11.2014, vërtetohet

2. Aktgjykimi i shkallës së parë përkritazi me pjesën refuzuese mbete i pa prekur.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr.472/14 të datës 20.11.2014, i akuzuari G.M është shpall fajtor për veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPK, është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 2.11.2012, deri me 21.01.2013. Pas shpallës se aktgjykimit me kërkesën e të akuzuarit dhe mbrojtësit tij, në kuptim të nenit 47 të KPK-së, dënimi me burgi i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1620 (njëmijë e gjashtë qind e njëzet) €, që gjithsejtë është obliguar të paguaj gjobën në shumë prej 2020 (dymijë e njëzet ) euro, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E akuzuara K.Q është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti, nuk kryen vepër tjetër penale.

Të akuzuarit G.M i është shqiptuar dënim plotësues, marrja e revoles e tipit “TAT Imp”, me numër serik 1027 e prodhimit kroat. Si dhe i ka obliguar që të dytë të i paguajnë shpenzimet e procedurës sa do të jenë sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 euro secili veç e veç, në afat prej 15 ditës, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. 11

Ndërsa përkritazi me veprën penale mbajtje në pronës, kontroll, posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par. 1 të KPK, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar akuzën, pasi që prokuroria ka hequr dorë nga kjo vepër penale sipas dispozitivit të dytë të aktakuzës, për të akuzuarin G.M.

Kundër aktgjykimit në afat ligjor ankesë ka paraqitur, PTH-DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që, gjykata e Apelit të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë vetëm sa i për ketë të akuzuarit G.M dhe ti shqiptoj dënim me të lartë.

Prokuroria e Apelit-DKR, me parashtrësën PPA/L.nr.582/15 të datës 22.12.2015, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PTH-DKR në Prishtinë, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit G.M, ti shqiptohet dënim më i lartë me burgim.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, nuk mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, meqenëse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e PTH-DKR në Prishtinë dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë, gjeti se :

Ankesa të PTH-DKR në Prishtinë është e pa bazuara.

Gjykata e Apelit duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, por e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Gjithë ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, sepse me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par. 2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Prokuroria në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë të akuzuarit G.M është i ulët, se gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si rrethanë lehtësuese ka marr parasysh, se i akuzuari është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale, nuk e ka marrë parasysh faktin se i dëmtuar ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit, dënimi i shqiptuar me burgim nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i ulët, me të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të i parandaloj të tjerët në kryerjen e veprave penale.

Kjo gjykatë gjen, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e përcaktimit të dënimit, drejtë i ka vlerësuar si rrethanat rënduese dhe lehtësuese që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese ka marrë, sjelljen e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, se më parë nuk ishte i dënuar, se është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe janë pajtuar, të cilat rrethana lehtësuese i pranon edhe kjo gjykatë, kurse prokurori nuk ka paraqitur rrethana tjera rënduese përveç se, i akuzuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat kanë qenë edhe objekt i akuzës.

Gjykata e Apelit, vlerëson Prokuroria në ankesë, nuk ka dhënë rrethana konkrete rënduese të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, përveç atyre që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana lehtësuese në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë, andaj pretendimet e prokurorisë në ankesë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, janë të

pa bazuara, sipas gjetjeve së kësaj gjykate, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në proporcion me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, e sipas bindjes edhe të kësaj gjykate me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK .

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.585/15, të dt.20.01.2016

Procesmbajtësja,  
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit  
Xhevdet Abazi

1. \_\_\_\_\_  
Have Haliti

2. \_\_\_\_\_  
Driton Muharremi